



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

NJOFTIM PER SHTYP

**Mbi workshopin në Durrës me biznesin dhe Universitetin
për prezantimin e politikës së konkurrencës dhe programin e ri të lehtësimit
nga gjobat**

Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” në qytetin e Durrësit zhvilloi ditën e martë, datë 28 qershor 2016 ora 11.00, workshopin për politikën kombëtare të konkurrencës dhe programin e ri të lehtësimit nga gjobat.

Në fjalën e saj kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës prof. Lindita Milo(Lati) u shpreh se për të ndërtuar një partnership real me komunitetin e biznesit, universitetin dhe pushtetin vendor të qarkut të Durrësit, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson si shumë të rëndësishme kontributin e biznesit për të identifikuar dhe diskutuar problematikat që ka tregu në këndvështrimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në tryezën e bashkëbisedimit me të gjithë palët e interesit.

Ky bashkëbisedim ndihmon për konsolidimin e draftit të dokumentit të politikës kombëtare të konkurrencës, i cili është rishikuar duke pasqyruar eksperiencën 12 vjeçare nga fillimi i zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe të Politikës së Konkurrencës.

Gjithashtu, janë pasqyruar gjetjet nga procesi i vlerësimit të zbatimit të Politikës dhe Ligjit të konkurrencës të realizuar nga ekspertët e UNCTAD, proces i kërkuar nga vetë Autoriteti i Konkurrencës, si dhe rekomandimet e Komisionit European të shprehura nëpërmjet raporteve sistematike të progresit.

Objekt diskutimi ishte edhe nisma që ka ndërmarrë Autoriteti i Konkurrencës në hartimin e një Programi të Ri të Lehtësimit nga Gjobat për biznesin, i cili synon bashkëpunimin me komunitetin e biznesit për zbulimin e praktikave anti-konkurrese kryesisht në rastet e prokurimeve publike për kartelet nëpërmjet ofertave plotësuese, nën kontraktimit ose rotacionit të shpalljes fitues.

Nga ana e biznesit, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe profesorëve të Universitetit “Aleksandër Moisiu” u vlerësua roli i Autoritetit të Konkurrencës si një nga institucionet më eficiente dhe u shtruan për zgjidhje problematikat që shqetësojnë biznesin kryesisht në sektorin e transportit, sektorin financiar, hidrokarburet, etj..